

## SKEMA E ÇERTIFIKIMIT PËR OPERATORËT E VINÇAVE; MAKINAVE NGRITËSE, TRANSPORTUESE DHE TË PUNIMIT TË TOKËS

### **KUSHTET PARAPRAKE**

Aplikantëve; kandidatëve dhe mbajtësve të certifikatave u kërkohet familjarizimi me rregulloret teknike përkatëse, teknologjitë, standardet dhe praktikën e shfrytëzimit/përdorimit/instalimit/mirëmbajtjes të vinçave; makinave ngritëse, transportuese dhe të punimit të tokës.

#### KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË:

- **GRUPI "A – 1":** Operator i vinçave kullë;
- **GRUPI "A – 2":** Operator i vinçave urë;
- **GRUPI "A – 3":** Operator i vinçave të lëvizshëm;

Kandidati, që dëshiron të certifikohet në cilin do nga grupet e me sipërme, duhet të përmbushi parakushtet për certifikim fillestar ose ricertifikim të përcaktuara më poshtë:

- a) Të ketë mbushur moshën 20 vjeç, duke e dëshmuar me një dokument identifikimi të vlefshëm.
- b) Të ketë mbaruar arsimin 8/9 vjeçar, duke e dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet përkatëse. (diplome, dëftesë, vërtetim etj.)
- c) Te jete i afte fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor, jo me i vjetër se 6 muajt e fundit, certifikatë mjekësore për operatorët e vinçave kullë dhe vinçave të lëvizshëm.
- d) Leje drejtimi të vlefshme nga autoriteti përkatës (për operatorin e vinçit mobile).
- e) Të disponoje certifikatën për sigurimin teknik elektrik të Grupi III, duke e dëshmuar me një kopje të saja.
- f) Certifikate e aftësisë për dhënie e ndihmës së pare, lëshuar nga Kryqi i Kuq, në rastet kur nuk është i pajisur me leje drejtimi.
- g) Të ketë kryer një trajnim në modelin specifik të makinerisë për të cilën do të certifikohet (vinç kullë; vinç urë; vinç I lëvizshëm).
- h) Trajnimi të paktën 30 orë, trajnime lidhur me sigurinë në punë.
- i) Të kenë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion. (Libreza e punës, vërtetim/referencë nga pune dhënësi etj.)
- j) Aplikanti duhet të ketë së paku 10 ditë pune, nën mbikëqyrje të një specialisti me përvojë në këtë fushë, si operator për vinça të përgjithshëm dhe të veçantë, dhe të paktën 1 muaj, si operator i vinçave, që operojnë në industrinë metalurgjike.

**KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË:**

- **GRUPI "B – 1":** Operator i makinerive ngritëse (pirunist);
- **GRUPI "B – 2":** Operator i makinave transportuese të stacionuara;

Kandidati, që dëshiron të certifikohet në cilin do nga grupet e me sipërme, duhet të përmbushi parakushtet për certifikim fillestar ose ricertifikim të përcaktuara më poshtë:

- a) Të ketë mbushur moshën 20 vjeç, duke e dëshmuar me një dokument identifikimi të vlefshëm.
- b) Të ketë mbaruar arsimin 8/9 vjeçar, duke e dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet përkatëse. (diplome, dëftesë, vërtetim etj.)
- c) Te jete i afte fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor, jo me i Vjeter se 6 muajt e fundit.
- d) Leje drejtimi te kategorisë B, të vlefshme nga autoriteti përkatës (për operatorin e grupit B-1).
- e) Të disponoje certifikatën për sigurimin teknik elektrik të Grupi III, duke e dëshmuar me një kopje të saja.
- f) Certifikate e aftësisë për dhënien e ndihmës së pare, lëshuar nga Kryqi i Kuq, në rastet kur nuk është i pajisur me leje drejtimi.
- g) Të ketë kryer një trajnim në modelin specifik të makinerisë për të cilën do të certifikohet (pirunë, pirunë teleskopik, makineri ngritëse, platforme ngritëse, makineri ngritëse transportuese).
- h) Trajnimi te paktën 30 orë, trajnime lidhur me sigurinë në punë.
- i) Aplikanti duhet të ketë së paku 300 ditë përvojë profesionale nën mbikëqyrje, ose minimum 100 ditë përvojë profesionale nën mbikëqyrje, për kandidatët që zotërojnë një diplomë të kualifikimit teknik (inxhinieri elektrike ose mekanike).

**KUSHTET PARAPRAKE PËR APLIKIM NË:**

- **GRUPI "C – 1":** Ekskavatorist: (për mjete me goma ose me zinxhirë);
- **GRUPI "C – 2":** Automaknist: autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda;
- **GRUPI "C – 3":** Buldozeris, (me rrota ose me zinxhirë);

Kandidati, që dëshiron të certifikohet në cilin do nga grupet e me sipërme, duhet të përmbushi parakushtet për certifikim fillestar ose ricertifikim të përcaktuara më poshtë:

- a) Të ketë mbushur moshën 20 vjeç, duke e dëshmuar me një dokument identifikimi të vlefshëm.
- b) Të ketë mbaruar arsimin 8/9 vjeçar, duke e dëshmuar me një dokument të lëshuar nga autoritetet përkatëse. (diplome, dëftesë, vërtetim etj.)
- c) Të jete i afte fizikisht dhe mendërisht për punë, veçanërisht lidhur me të parët, të dëgjuarit, aftësisë lëvizëse, etj. Vërtetim mjekësor, jo më i Vjeter se 6 muajt e fundit.
- d) Leje drejtimi të vlefshme nga autoriteti përkatës (për operatorin e buldozerëve; eskavatorëve; autovinça; autobetoniere; autobetonpompa; autobitumatrine dhe autosonda).
- e) Patente dhe leje: të qarkullimit rrugor, për makineritë me rrota gome,

- f) Të disponoje certifikatën për sigurimin teknik elektrik të Grupi III, për operatorët që punojnë me ekskavator elektrik, duke e dëshmuar me një kopje të saja.
- g) Certificate e aftësisë për dhënien e ndihmës së pare, lëshuar nga Kryqi i Kuq, në rastet kur nuk është i pajisur me leje drejtimi.
- h) Të ketë kryer një trajnim në modelin specifik të makinerisë për të cilën do të certifikohet (ekskavatorist; autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, autobitumatrine, autosonda, bldozer, rrula etj.).
- i) Trajnimi të paktën 30 orë, trajnime lidhur me sigurinë në punë.
- j) Aplikanti duhet të ketë së paku 10 ditë pune, nën mbikëqyrje të një specialisti me përvojë në këtë fushë, si operator për vinça të përgjithshëm dhe të veçantë, dhe të paktën 1 muaj, si operator i vinçave, që operojnë në industrinë metalurgjike.

Plotësimi i kërkesave paraprake, vërtetohet nga vlerësuesit paraprak. Nëse aplikanti plotëson kërkesat paraprake të skemës së certifikimit, atëherë, ai i nënshtrohet procesit të certifikimit dhe kryen pagesën paraprakisht. Në rast se aplikanti nuk i plotëson kërkesat paraprake, atëherë vlerësuesi paraprak, e lajmëron atë, (me shkresë zyrtare, ose me e-mail), për kriteret që ai nuk plotëson dhe procedura e certifikimit nuk fillon për të.

**Shënim:** Kandidati duhet të zotëroj gjuhen shqipe në të shkruar dhe të folur. Në rastet kur kandidati është i huaj, organi certifikues mund të sigurojë përkthimin, nëse do ketë kosto shtese do përballohet nga kandidati.